



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 dhjetor 2015
Nr. ref.:RK864/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI25/15

Parashtrues

Faik Azemi

**Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme të Aktvendimit të Gjykatës
Kushtetuese për papranueshmëri KI129/14, të 25 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Faik Azemi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi në kërkesë kërkon kthimin në gjendjen e mëparshme në kuptim të afatit të paraparë, të Aktvendimit për papranueshmëri KI129/14, të Gjykatës Kushtetuese, të 25 nëntorit 2014.
3. Kësaj kërkesë, parashtruesi ia ka bashkangjitur disa kërkesa të tij të drejtuara gjykatave të rregullta për qasje në dosjen e lëndës. Dokumentet e përmendura, parashtruesi i kërkesës ia kishte bashkangjitur edhe kërkesës së tij të mëparshme, KI129/14.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme të Kërkesës KI129/14, të 25 nëntorit 2014.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI25/15, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI25/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KI25/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit më 26 qershor 2015 i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 21 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 10 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë, në të cilën kërkoi nga Gjykata kthimin në gjendjen e mëparshme në kuptim të afatit të paraparë të Aktvendimit për papranueshmëri KI129/14, të 25 nëntorit 2014, në të cilin ai paraqitet si parashtrues i kërkesës.
12. Parashtruesi i kërkesës, në shtojcë të kërkesës së re bashkëngjiti dokumentacionin e njëjtë i cili ka qenë i bashkangjitur me kërkesën KI129/14, të 25 nëntorit 2014.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri, KI129/14, të 25 nëntorit 2014

13. Më 29 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 515/2007) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës së marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë në mënyrë të paligjshme dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës që t'ia pranojë parashtruesit të kërkesës të gjitha të drejtat që i kishte pasur për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007.
14. [...]
15. Më 12 gusht 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktvendimi CA. nr. 3581/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurës – Komunës së Prishtinës dhe vërtetoi Aktvendimin (C. nr. 1816/09) e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
16. [...]
17. Më 4 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi Rev. nr. 270/2013) pranoi revizionin e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, anuloi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe e ktheu lëndën në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës e pranoi këtë vendim më 20 mars 2014.
18. Më 8 prill 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin AC. nr. 3779/13 e refuzoi ankesën e debitorit – Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1220/13, të 12 nëntorit 2013.
19. Më 13 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese në të cilën e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 270/2013] e Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2014, të cilin e ka pranuar më 20 mars 2014.
20. Në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të paraqitura në kërkesë, Gjykata më 25 nëntor 2014, konstatoi se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, deklarohet e papranueshme sepse është e paafatshme.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:

„Tek pastaj kur më është mundësuar shiqimi i lëndës pas 10 kërkesave disaditëshe, e kam parë se Gjykata Supreme me procedura kryeneçe, arbitrare dhe të padrejta ka nxjerr vendimin kundërligjor, të cilin e kam kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese”.

22. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se në kërkesën e tij të mëparshme KI129/14 ka kërkuar në mënyrë plotësuese që kërkesa e tij të shqyrtohet si e pranueshme në kuptim të afatit të paraparë, por kjo kërkesë nuk është protokolluar dhe shqyrtuar nga Gjykata.
23. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

„që në bazë të nenit 50 të Ligjit për GJK ta aprovoni kërkesën time për kthim dhe të merrni vendim merit, gjegjësisht ta anuloni Vendimin e Gjykatës Supreme, sfiduar me nr. KI129/14.”

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“36 (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkëljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 50 të Ligjit, i cili përcakton:

“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.”

27. Gjykata i ka shqyrtuar në tërësi shkresat e bashkangjitura me këtë kërkesë dhe me kërkesën KI129/14. Gjykata vëren se është fakti që parashtruesi në kërkesën e tij të mëparshme KI129/14 ka kërkuar në mënyrë plotësuese që kërkesa e tij të shqyrtohet si e pranueshme në kuptim të afatit të paraparë dhe në mbështetje të kësaj, ai tre herë (më 25 shtator 2014, 22 tetor 2014 dhe 30 tetor 2014) kishte dorëzuar në Gjykatë dokumentet e caktuara, të cilat janë regjistruar nga Gjykata.

28. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi më 20 mars 2014 e pranoi Aktvendimin [Rev. nr. 270/2013] e Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2014. Këtë fakt e ka konfirmuar Gjykata Themelore në Prishtinë duke e dorëzuar kopjen e

fletëkthesës. Parashtruesi i kërkesës duke paraqitur dokumentacion shtesë, pretendon se nuk ka pasur qasje në shkresat e lëndës para gjykatave të rregullta, e në fakt, Aktvendimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit më 20 mars 2014, domethënë parashtruesi ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, por thjesht nuk arriti të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

29. Përkitazi me këtë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendje të mëparshme, siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar.
30. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtare raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi